

NË VEND TË PARATHËNIES

BASHKIM SPAHIA



Viti i lindjes: 1947

Eksperiencë pune: 43 vjet. Eksperiencë pune në KLSH: 31 vjet, në pozicionet Auditues, Auditues i Lartë dhe Drejtues Departamenti. Nga viti 2012 dhe deri në daljen në pension në dhjetor 2013, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme në KLSH.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i Ligjshmërisë dhe Përputhshmërisë

KLSH DHE RISITË E VITEVE 2012-2013ⁱⁱⁱ

nga Bashkim Spahia

Ish-Auditues i Lartë në KLSH, sot në pension

Bëra 31 vite punë në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe këtë vit dola në pension. Për mua, ky institucion është një pjesë e pandarë e jetës sime. Do të desha që fryma të më lërë, duke ngjitur shkallët e këtij institucioni, ose në biseda me ish-kolegët e mij. Në dy vitet e fundit, kam parë KLSH të rritet në autoritet dhe karakter. Fjala e audituesit të peshojë më shumë. Ky institucion nuk ka kryer vetëm më shumë auditime, sikurse thekson Progres Raporti i BE-së i vitit 2013. Vetë raportimet e tij njohën ngritje në cilësi. Kallzimet penale janë dosje më të përgatitura e të bazuara në ligj, marrëdhëniet me Prokurorinë janë më profesionale e konstruktive. Asnjëherë më parë KLSH nuk ka patur këtë hapje me publikun dhe me shoqërinë civile, sa në vitet 2012-2013. Këto dy vjet, çdo audituesi i është dhënë shansi të paktën njëherë të shkojë me shërbim jashtë shtetit dhe të shohë si auditojnë kolegët e tij të

institucioneve simotra më të zhvilluara. Audituesit tani përdorin më dendur referimet ndaj standardeve ndërkombëtare të fushës, INTOSAI. Këtë e bëjnë jo vetëm në trajnimet që zhvillohen. Kam parë rritje të prekshme të cilësisë në raportimet për auditimet e përputhshmërisë dhe auditimet financiare. 14 ndër audituesit më me përvojë të institucionit dhe auditues të rinj me perspektivë, në tetor 2012 themeluan Departamentin e Auditimit të Performancës, që është e ardhmja e këtij institucioni, për nga rëndësia dhe ndikimi në ekonominë dhe shoqërinë e vendit. KLSH në 14 muajt tetor 2012-dhjetor 2013 ka rritur ndjeshëm numrin dhe cilësinë e auditimeve të performancës. Drejtuesit e institucionit kanë thelluar përdorimin e analizës së riskut në procesin e planifikimit të auditimeve. Duke qenë se në vitet e fundit kam punuar pranë Drejtorisë Juridike dhe të Sigurimit të Cilësisë, kam qenë vetë dëshmitar i përmirësimit të dukshëm të kontrollit të cilësisë së auditimeve, i cili kryhet nëpërmjet shqyrtimeve “në të nxehtë” dhe “në të ftohtë”. Kërkoj ndjesë për përdorimin e këtyre termave teknikë të profesionit, por dua të siguroj lexuesin se tani kontrolli i cilësisë nuk kryhet më formal, por kërkon me ngulm cilësinë mbi bazën e standardeve INTOSAI, si dhe rrit llogaridhënien. Më kujtohet se si një personalitet i auditimit evropian dhe atij ndërkombëtar, ish-Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI dhe Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, Dr. Franz Fiedler, në një takim me auditues shqiptarë në vitin 2002, shprehej se :”investimi më i rëndësishëm dhe madhor për një SAI(institucion suprem auditimi) janë kapacitetet audituese”. Mund ta them me plot gojën se në këto dy vjet, KLSH ka bërë rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve më shumë sa ç’është bërë përgjatë një dekade të fundit 2002-2011. Ka ndodhur shtimi me herë i ditëve të trajnimit në vit për çdo auditues. Me ekspertë të huaj nga programi i BE-së dhe i OECD-së, SIGMA, janë zhvilluar këtu trajnime për auditimet e performancës, të analizës së riskut, të auditimit financiar, të auditimit të

përputhshmërisë, të auditimit të prokurimeve publike dhe të auditimit të teknologjisë së informacionit. Ndërsa numri i audituesve të dalë jashtë shtetit është i barabartë me atë të atyre që nga institucioni kanë dalë jashtë gjatë tetë viteve 2004-2011 të marra së bashku. Asnjëherë institucioni nuk ka njohur më parë një ritëm dhe numër të tillë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucionet e tjera supreme të auditimit(SAI-t partnere). Në dy vjet, KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi më shumë si numër(me SAI-t e Austrisë, Sllovenisë, Polonisë, Turqisë, Kosovës, Kroacisë, Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës dhe Maqedonisë), nga sa janë lidhur gjatë viteve 1992-2011. Për herë të parë këto marrëveshje nuk kanë qëndruar formale, thjesht në letër, por janë shndërruar në vizita pune dhe trajnime në shtetet partnere, ose në pjesëmarrje në aktivitete shkencore të zhvilluara nga të dyja palët. Trajnimet si brënda dhe jashtë shtetit janë zhvilluar mbi bazën e kërkesave dhe nevojave reale të audituesve tanë. Ndoshta të gjitha këto do të kishin pak vlerë, nëse nuk do të kishte ndodhur një risi dhe metamorfozë e pëlqyeshme për mua, në këtë institucion që i kam kushtuar jetën. Ka ndodhur rritja e kulturës audituese në institucion. Kolegët e mij i shoh gjithnjë e më shumë duke përdorur librin, duke cituar thënie të personaliteteve të njohura botërore të auditimit. Për këtë kanë ndikuar botimet e specializuara të KLSH, që përbëjnë një risi absolute të institucionit. Janë 20 tituj, libra shkencore për standardet e auditimit, libra historikë për historikun e KLSH, historinë dhe profilin e INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, manuale të llojeve të ndryshme të auditimit, libra të performancës së institucionit dhe raporteve të auditimit të Buxhetit të Shtetit, të gjitha të realizuara me një fond të kursyer prej vetëm 3.2 milionë lekë të reja në 2 vjet. Gjatë vitit 2012, për herë të parë, gazetarët e mediave u ftuan dhe morën pjesë në analizat vjetore në nivel departamenti auditimi në KLSH. Gjatë vitit 2013, 42 auditues shkruan për herë të parë në gazetatat e vendit, duke shfaqur në shkrimet dhe analizat e tyre idetë që kanë

hedhur në raportet e auditimit, si dhe ide më të gjera për reformat kryesore që duhen kryer të plota në fusha të ndryshme të aktivitetit publik. Prej dy vjetësh, KLSH boton revistën shkencore katërmujore “Auditimi Publik”, me kontribute nga personalitete të auditimit evropian, si ish-Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI dhe ish-President i SAI-t polak, Jacek Jezierski, Prof. Asoc. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Robert Gielisse, Drejtor Drejtorie në DG-Budget, Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA, etj., krahas shkrimeve, eseve dhe studimeve të akademikëve vendas dhe të audituesve të institucionit. Në Nëntor 2013, institucioni mori pjesë, për herë të parë, me një pavion modest, në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Tiranë. Në dhjetor 2013, institucioni realizoi Konferencën e dytë Shkencore të tij, me 27 studime, prezantime dhe kumtesa nga përfaqësues të DG-Budget, Gjykatës Evropiane të Audituesve, SAI-ve partnere dhe SIGMA, si dhe nga akademikë, personalitete vendase të kontabilitetit dhe auditimit, nga shopëria civile dhe drejtues e auditues të lartë të KLSH. Sot, në dy korridoret e gjata, të larta dhe të ngushta kryesore të tij, ka dritë. Ndryshe nga errësira dhe muret e zhveshura, me të cilat më ishin mësuar sytë ndër dekada. Janë dritat e miniekspozitës “KLSH- 88 vjet histori”, të sistemuar në këto korridore dhe që do të jete e përhershme, duke u pasuruar me stenda të reja. Është një kujtesë permanente e vlerave të tij dhe përbën një motiv pse jam krenar që jam pjesë e këtij institucioni (edhe pse kam dalë në pension). Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme (ndoshta ndër më kryesoret), kam qenë dëshmitar në këta dy vjet si trajtohen punonjësit me eksperiencë dhe që kanë një kontribut të gjatë në këtë institucion kushtetues. Është shfaqja më njerëzore dhe respekti më profesional që mund t’i ofrohet një punonjësi të ndershëm dhe të përkushtuar të shtetit tonë. Dhe kjo, në sajë të ndjeshmërisë maksimale të Kryetarit të KLSH, z. Bujar Leskaj. Jam i

bindur se me këto vlera njerëzore dhe profesionale, KLSH do të jetë në nivel të sfidave që e presin gjatë viteve të ardhshme.

ⁱ Shkrimi është botuar në Gazetën “Panorama” në 10 janar 2014. U dorëzua në gazetë në fund të vitit 2013.

ⁱⁱ Ky shkrim u zgjodh në vend të Parathënies, jo vetë pse në të sintetizohen risitë e KLSH në këto dy vite 2012-2013, si rritja e cilësisë në auditim, e kapaciteteve audituese, e transparencës dhe informimit të publikut, e bashkëpunimit efektiv me partnered vendas dhe të huaj, etj., por si respekt i Kryetarit dhe gjithë stafit të KLSH për punën, profesionalizmin dhe integritetin e z. Bashkim Spahia.